



BROSHURË PËR PRINDËRIT

Përmbledhje e shkurtër

DITARI I ZGJEDHJES SË PROFESIONIT

Daniel Jungo • Erwin Egloff

Të dashur prindër

Me hyrjen në nivelin dytësor të I-rë, zgjedhja e profesionit për të rinjtë bëhet aktuale. Ju si prindër mund të merrni përsipër një rol mbështetës gjatë gjetjes së profesionit, duke stimuluar, mbështetur dhe inkurajuar. Ju jeni pika më e afërt dhe më e rëndësishme e kontaktit për të rinjtë. Kjo broshurë për prindërit tregon mënyrën se si ju mund ta shoqëroni më së miri fëmijën tuaj gjatë zgjedhjes së profesionit.

Ju urojmë juve dhe vajzës apo djalit tuaj fat dhe sukses gjatë zgjedhjes së profesionit.

Forcimi i fëmijës suaj

Për ta forcuar fëmijën tuaj për zgjedhjen e profesionit është e rëndësishme të mbahet një qëndrim pozitiv. Një metodë e favorshme është një drejtim i kuptueshëm dhe partneritet në forcimin e mënyrave pozitive të sjelljes.

Sjellje të përmbledhura me shembuj nga prindërit:

Vetëbesimi

«Vajza jonë ka takuar mësuesin sepse ka ndjerë që nota e vënë ishte e padrejtë.»

Pavarësi

«Djali ynë na ka habitur kur, në mënyrë të pavarur, ka organizuar një praktikë trajnimi.»

Nismë

«Për vajzën tonë, koha e lirë është gjithmonë shumë e shkurtër. Ajo gjen gjithmonë një veprimtari në kohën e lirë, që i sjell kënaqësi.»

Durim

«Djali ynë ka një hobi të veçantë: Ai interesohet në mënyrë të detajuar për makinat e postës.»

Aftësi në marrëdhënie

«Djali ynë i madh është pak i turpshëm. Por ai ka tre shokë që e vizitojnë gjithnjë.»

Karakteristika të një sjellje të kuptueshme dhe bashkëpunuese

- Kuptimi i ndjenjave
- Tregimi i kuptueshmërisë
- Ofrimi i ndihmës
- Stimulimi i të menduarit
- Lejimi i hapësirave për të vendosur

Mendoj se ke përpiluar një letër të bukur aplikimi. Kam edhe dy sugjerime se si mund ta formulosh edhe më mirë.




KËSHILLË

- Forconi sjellje të tilla pozitive si vetëbesim, pavarësi, iniciativë, durim dhe aftësi në marrëdhënie.

Modeli i bashkëpunimit

Modeli i bashkëpunimit tregon se vetëm prindërit mund t'i ndihmojnë të rinjtë në zgjedhjen e profesionit. Këtu bashkëveprojnë edhe shkolla, konsulencia e profesionit dhe ekonomia.



Modeli i bashkëpunimit për përgatitjen e zgjedhjes së profesionit tregon partnerët më të rëndësishëm.

Pesë hapa për gjetjen e profesionit


Për fëmijën tuaj kalimi nga shkolla fillore në profesion apo në shkollë të mesme bëhet në hapa të ndryshëm. Qëllimi është të gjendet një zgjidhje lidhëse.

1

Unë njoh vetveten

Njohja e interesave dhe aftësive

- Përcaktimi i vendndodhjes dhe vetëvlerësimi me fletoren e punës
- Vëzhgime në kohën e lirë dhe në shkollë
- Biseda me prindër, mësues, konsulentë të karrierës



2

Unë njoh botën e profesionit

Mbledhja e informacioneve për profesionet

- Qendra e informacioneve për profesionin BIZ: Literatura e përgjithshme, profile të profesionit, mjete informative për një studim, revista për zgjedhjen e profesionit
- Oferta të internetit
- Eksplorime të profesionit



KËSHILLË

- Herë pas here eksploroni në lidhje me temat mbi të cilat po punon fëmija juaj, dhe informohuni për to.

E krahasoj veten me botën e profesionit

3

Gjetja e synimeve të përshtatshme të profesionit dhe trajnimit

- Pyetësorë të interesave, busulla e interesave dhe regjistri i profesioneve
- Lista rendore e profesioneve të preferuara
- Të preferuarat dhe kërkesat
- Biseda me prindër, mësues/-e, konsulentë/-e të karrierës

Unë eksploroj profesione dhe vendos

Përjetimi i botës së profesionit dhe marrja e vendimeve

- Praktika trajnimi
- Biseda me profesionistë dhe me mësues/-e
- Eksplorime të profesionit
- Inspektime të profesioneve dhe orientime
- Seanca informative
- Kontrolli i shanseve: Informacione, shanset për vendet e praktikës, mundësi devijimi, etj.

4



Unë e bëj realitet vendimin tim

Gjetja e vendit të praktikës

- Kërkimi i adresave të vendeve të praktikës
- Shkrimi i aplikimeve
- Biseda prezantuese
- Sjellja me refuzimet

Gjetja e zgjidhjes së ndërmjetme ose ofertës lidhëse

- Përmirësimi i shanseve
- Përgatitja për profesion ose shkollë
- Thellimi i njohurive gjuhësore

Planifikimi i shkollimit të mëtejshëm

- Zgjedhja e shkollës
- Transferimi
- Arritja e pranimit

5





Njohja e rutinës së profesionit

Për të rinjtë është e rëndësishme dhe tërheqëse të përjetojnë direkt rutinën e profesionit. Kësisoj, ata hedhin një hap të madh drejt qëllimit të gjetjes së profesionit.



Të rinjtë përballen me realitetin profesional dhe i hedhin një sy botës së punës.

- Eksploime të profesionit
- Inspektime dhe orientime të profesioneve, seanca informative
- Vizitimi i praktikave, vende praktikash (praktika e zgjedhjes së profesionit)
- Biseda me profesionistë

Kërkimi i vendeve të praktikës

Kontakti me listat e adresave të kompanive të rinj të mund të aplikojnë për vende të lira për praktikën.



KËSHILLA

- Ndhmoni në kërkimin e vendeve të praktikës.
- Për dëshmi të vendeve të praktikave përdorni adresat e internetit më poshtë **www.berufswahltagbuch.ch/lehrstellen**
- Kërkoni ndihmën dhe adresat nga të afërmit, të njohurit dhe mësuesit.
- Merrni parasysh njoftimet e vendeve vakante në gazeta dhe internet.
- Pyesni kompanitë drejt për drejt.
- Merrni parasysh njëkohësisht profesione të përafërta.



Biseda prezantuese

Përshtypja e lënë në bisedën prezantuese është përcaktuese për suksesin e aplikimit. Prindërit nuk mund t'i parandalojnë refuzimet, por mund ta zbusin zhgënjimin.



KËSHILLA

Praktikojeni bisedën prezantuese

- «Pse dëshiron ta mësosh këtë profesion?»
- «Sa e njeh këtë profesion?»
- «Cilat janë pikat e tua të forta dhe të dobëta?»

Çfarë mund të bëni në rast refuzimi


- Mos u shkurajoni.
- Tregojini fëmijës suaj se i ndani me ta ndjenjat e pakëndshme dhe e kuptoni.
- Kërkoni së bashku një zgjidhje.

Këshilla si të silleni me refuzime të shpeshta

- Kërkoni se cilat ishin arsyet e refuzimit.
- Mbështeteni fëmijën tuaj në aplikimet e tjera.
- Kontrolloni dokumentat e aplikimit.
- Merrni mbështetje nga mësuesi ose konsulenca e profesionit.

Sistemi arsimor i Zvicrës

Në fund të shkollës së detyruar, ka shumë trajnime profesionale dhe akademike. Mësoni rrugët e ndryshme të trajnimit, në mënyrë që ju së bashku me fëmijën tuaj të mund të merrni një vendim të drejtë. Ilustrimi tregon rrugëte zgjedhura më shpesh në sistemin e arsimit të Zvicrës. Në raste të veçanta, janë të mundshme rrugë të tjera.



Vijat më të errëta tregojnë rrugët e trajnimit në të cilat aksesimi është i mundshëm direkt.



Për rreshtat më të çelura nevojiten kualifikime shtesë ose praktikë profesionale.

Impressum

BERUFSWAHLTAGEBUCH
Elternheft Kurzfassung Albanisch

Autoren Daniel Jungo, Erwin Egloff **Projektleitung** Bruno Bachmann
Herstellung Katja Iten **Gestaltung** Hansen Typografische Gestaltung, Luzern
Illustrationen Sarah Safu Furrer **Übersetzung** Apostroph Luzern AG, Luzern
Bilder Seite 2 © Christoph Hähnel – Fotolia.com; © PeopleImages/www.istockphoto.com
Seite 6 Andreas Gerosa, Heini Gubler **Seite 7** © auremar – Fotolia.com

© 2017 Schulverlag plus AG (übersetzte, gekürzte Ausgabe von Art.-Nr. 88646)
Das Werk und seine Teile sind urheberrechtlich geschützt.
Jede Verwertung in anderen als den gesetzlich zugelassenen Fällen bedarf der vorherigen schriftlichen Einwilligung des Verlags.